



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-100  
Prishtinë, më 13 prill 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 13 PRILL 2010**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Petar Miletqi, Xhezair Murati dhe Numan Baliq;

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca;

Nga Presidenca e Kosovës, Lumnije Murati;  
Nga ICO: Blerta Bejtullahu;  
Nga OSBE: Lejla Selimi, dhe  
Nga NDI, Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe dy pika shtesë:

1. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar për anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në Gjermani,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Kryesia u pajtua me propozimin e kryetarit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d i t e**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 prill 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, që do të mbahet më 29 prill 2010, dhe
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 prill 2010**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 prill 2010, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare, që do të mbahet më 29 prill 2010**

**Kryesia**, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 29 prill 2010, me këtë:

## R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2009,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2009,
6. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2009,
7. Shqyrtimi i dytë i Propozim - Rregullores së Kuvendit,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave**

#### **3.1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

#### **3.2. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Buxhetin për vitin 2009**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Raportin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Buxhetin për vitin 2009 dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

### **3.3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2009**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

### **3.3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

### **3.5. Njoftimi me kërkesën e Sindikatës së Pavarur të PTK-së për kundërshtimin e privatizimit të PTK-së**

**Kryetari** konstatoi se peticioni në fjalë u është shpërndarë anëtarëve të Kryesisë, vetëm për njoftim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, Nexhat Daci, Xhavit Haliti dhe Ramë Buja, që janë paraqitur në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

### **3.6. Njoftim me kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, drejtuar Qeverisë së Kosovës për plotësimin e Informatës për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010**

**Kryetari** konstatoi se kërkesa në fjalë u është shpërndarë anëtarëve të Kryesisë, vetëm për njoftim.

## **Pikat shitesë**

### **1. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar për anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në Gjermani**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa : Gani Koci, Kosara Nikoliq, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Suzana Novoberdaliu, Besa Gaxherri, Mufera Shinik dhe Xhevdet Neziraj, si dhe Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit dhe zyrtarët: Natasha Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli, në Gjermani, prej 18 - 24 prill 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon Organizata Gjermane për bashkëpunim teknik GTZ, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

### **2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat të Njeriut ... për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi t'i propozojë Kuvendit, në seancë plenare të 29 prillit 2010, lejimin e një afati shtesë prej 15 ditësh.

Për këtë pikë të rendit të ditës, e ndërlidhur edhe me pikën paraprake, diskutuan: Jakup Krasniqi, Nexhat Daci, Ibrahim Makolli, Naim Maloku, dhe Sabri Hamiti, që janë paraqitur në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, **kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë se nga data 21-23 prill 2010, me ftesë të Parlamentit Bullgar, ai do të kryesojë delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për vizitë zyrtare në këtë vend.

Kryesia, pasi shqyrtoi njoftimin e kryetarit për vizitë zyrtare në Bullgari, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Kuvendit, zotit Jakup Krasniqi, të anëtarëve të Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Sllobodan Petroviç, si dhe të Mehmet Hajrizit, këshilltar politik, të Skënder Reçicës, këshilltar për protokoll dhe të Gëzim Vllasaliut, zyrtar për siguri, në Bullgari, prej 21- 23 prill 2010.

2. Të gjitha shpenzimet e vizitës të cilat nuk mbulohen nga Parlamenti i Republikës së Bullgarisë, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve, përballohet nga buxheti i Kuvendit.

\*\*\*

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në ora 11:37 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

Hartoi: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale